

NDËRTIMET PUBLIKE DHE ZHVILLIMI URBAN I PRISHTINËS NË
JUGOSLLAVINË SOCIALISTE (1945-1989), ME THEKS TË VEÇANTË PAS
VITIT 1968

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I HISTORISË

NGA

RINA MAKSUTAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

QERSHOR, 2026

REZYME

“NDËRTIMET PUBLIKE DHE ZHVILLIMI URBAN I PRISHTINËS NË JUGOSLLAVINË SOCIALISTE (1945-1989), ME THEKS TË VEÇANTË PAS VITIT 1968”

Mentori: Prof. Ass. Dr. Mentor Hasani

Kandidatja: Rina Maksutaj

Ky punim trajton procesin e zhvillimit urban të Prishtinës gjatë periudhës së Jugosllavisë socialiste (1945-1989), me theks të veçantë në rolin që patën ndërtimet publike në transformimin hapësinor, funksional dhe shoqëror të qytetit, veçanërisht pas vitit 1968. Gjatë kësaj periudhe, Prishtina kaloi nga një qendër urbane me tipare tradicionale në një qytet modern me funksione të zgjeruara administrative, arsimore, kulturore dhe ekonomike.

Zhvillimi urban i Prishtinës ishte i lidhur ngushtë me ndryshimet politike dhe institucionale të kohës, si dhe me politikat zhvillimore të sistemit socialist. Ndërtimi i institucioneve publike, zgjerimi i infrastrukturës urbane dhe hartimi i planeve urbanistike ndikuan drejtpërdrejt në organizimin e hapësirës dhe në formësimin e identitetit urban të qytetit.

Ky hulumtim synon të analizojë politikat urbane të zbatuara në Prishtinë gjatë periudhës socialiste, të shqyrtojë rolin e shtetit në planifikimin urban dhe ndërtimin publik, si dhe të vlerësojë ndikimin e këtyre proceseve në transformimin urban dhe shoqëror të qytetit.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të shqyrtojë dhe analizojë procesin e zhvillimit urban të Prishtinës gjatë periudhës së Jugosllavisë socialiste (1945-1989), me theks të veçantë në rolin që ndërtimet publike luajtën në transformimin e strukturës urbane dhe funksionale të qytetit. Studimi synon të evidentojë lidhjen ndërmjet politikave shtetërore, ideologjisë socialiste dhe proceseve të urbanizimit, si dhe të vlerësojë ndikimin e tyre në formësimin e identitetit urban të Prishtinës.

Objektivat specifike të hulumtimit janë:

- Analizimi i gjendjes urbane të Prishtinës para dhe pas Luftës së Dytë Botërore.
- Shqyrtimi i politikave urbane të Jugosllavisë socialiste dhe ndikimit të tyre në zhvillimin e qytetit.
- Identifikimi dhe analizimi i ndërtimeve kryesore publike të realizuara gjatë periudhës 1945-1989.
- Vlerësimi i ndikimit të zhvillimit urban dhe të ndërtimeve publike në transformimin funksional dhe shoqëror të Prishtinës.
- Analizimi i ndikimit të ideologjisë socialiste në arkitekturë dhe planifikimin urban.
- Evidentimi i trashëgimisë urbane të periudhës socialiste dhe rëndësisë së saj në identitetin bashkëkohor të qytetit.

Pyetjet hulumtuese

- 1. Cilat ishin politikat kryesore urbanistike të aplikuara në Prishtinë gjatë periudhës socialiste?*
- 2. Si ndikuan ndërtimet publike në transformimin urban dhe funksional të qytetit pas vitit 1968?*
- 3. Çfarë roli luajtën zhvillimet politike dhe institucionale në intensifikimin e ndërtimit publik?*
- 4. Si u reflektua ideologjia socialiste në planifikimin urban dhe arkitekturën publike të Prishtinës?*

Metodologjia e punimit

Ky hulumtim mbështetet në një qasje historike shkencore, duke përdorur metodën historiko-analitike dhe metodën krahasuese, me qëllim të analizimit të zhvillimit urban të Prishtinës gjatë periudhës së Jugosllavisë socialiste (1945-1989). Këto metoda kanë mundësuar analizimin kronologjik të zhvillimit urban të Prishtinës dhe identifikimin e faktorëve politikë, institucionalë dhe shoqërorë që ndikuan në procesin e urbanizimit.

Burimet e përdorura në këtë hulumtim ndahen në burime primare dhe sekondare. Burimet primare përfshijnë dokumente arkivore, plane urbanistike, vendime institucionale dhe shtypin e kohës, ndërsa burimet sekondare përbëhen nga literaturë shkencore vendore dhe ndërkombëtare që trajton zhvillimin urban dhe arkitekturën në kontekstin jugosllav.

Analiza e të dhënave është realizuar përmes interpretimit kritik dhe krahasues të burimeve, me qëllim të evidentimit të vazhdimësive dhe ndryshimeve në zhvillimin urban të Prishtinës gjatë periudhës së studiuar.

Rezultatet e hulumtimit

Rezultatet e hulumtimit mundësojnë vërtetimin e hipotezës së parë, sipas së cilës zhvillimi urban i Prishtinës ishte i kushtëzuar drejtpërdrejt nga politikat shtetërore socialiste dhe u realizua kryesisht përmes ndërtimit të objekteve publike. Gjithashtu u vërtetua edhe hipoteza e dytë, e cila argumentonte se ndërtimet publike pas vitit 1968 pasqyronin rritjen e rolit institucional të Kosovës dhe ndikuan në riorganizimin funksional dhe hapësinor të qytetit. Njëkohësisht, analiza e ndikimeve demografike, shoqërore dhe kulturore dëshmoi edhe vlefshmërinë e hipotezës së tretë, pasi urbanizimi socialist ndikoi në transformimin e mënyrës së jetesës, në zgjerimin e hapësirave publike dhe në formimin e një identiteti të ri urban.

Përfundimet

Hulumtimi mbi ndërtimet publike dhe zhvillimin urban të Prishtinës gjatë periudhës së Jugosllavisë socialiste (1945-1989), me theks të veçantë pas vitit 1968, dëshmoi se transformimi i qytetit ishte rezultat i ndërveprimit të politikave shtetërore, zhvillimeve institucionale dhe proceseve të planifikimit urban. Analiza e zhvillimeve historike tregoi se Prishtina kaloi nga një qendër urbane me tipare kryesisht tradicionale në një qytet modern administrativ, arsimor, kulturor dhe shëndetësor, duke marrë gradualisht funksionet e qendrës kryesore të Kosovës.

Hulumtimi tregoi se politikat urbanistike të periudhës socialiste u mbështetën në planifikimin e centralizuar, në ndarjen funksionale të hapësirës urbane dhe në rolin dominues të shtetit në organizimin e zhvillimit të qytetit. Planet urbanistike të hartuara pas Luftës së Dytë Botërore,

veçanërisht Plani i Përgjithshëm Urban i vitit 1953, krijuan bazën për transformimin e strukturës urbane të Prishtinës dhe për zgjerimin e saj të mëvonshëm.

Rezultatet e hulumtimit treguan se zhvillimet politike dhe institucionale pas vitit 1968 krijuan kushte të favorshme për intensifikimin e ndërtimit publik. Rritja e autonomisë së Kosovës, zgjerimi i kompetencave institucionale dhe shtimi i investimeve publike ndikuan drejtpërdrejt në realizimin e projekteve të shumta urbane, të cilat e ndryshuan dukshëm fizionominë e qytetit.

Fjalët kyçe:

Prishtinë, urbanizim socialist, ndërtimet publike, zhvillim urban, etj.